

Në
këtë
periodik
do të lexoni:

Përmbillet me sukses në Tiranë
Konferenca Vjetore e IAIS 2025,
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
mikëpritësi i këtij aktiviteti të rëndësishëm



VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri,
Janar-Tetor 2025

5

ZHVILLIME TË TJERA

6-11

INFORMACIONE NDËRKOMBËTARE

12-14

**Përmbillet me sukses në Tiranë
Konferenca Vjetore Globale e Organizatës Ndërkombëtare të
Mbikëqyrësve të Sigurimeve 2025.
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,
mikëpritësi i këtij aktiviteti.**



Përfundoi me sukses Konferenca Vjetore e Organizatës Ndërkombëtare të Mbikëqyrësve të Sigurimeve (IAIS), e organizuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në bashkëpunim me IAIS. Aktiviteti, ndër më të rëndësishmit në shkallë globale për sektorin e sigurimeve, mbledhi mbi 500 përfaqësues nga më shumë se 130 juridiksione, përfshirë autoritete mbikëqyrëse, organizata financiare ndërkombëtare dhe kompani sigurimi nga mbarë bota.

Në ditën e dytë, në fjalën e saj përshëndetëse Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit, znj. Mimoza Kaçi, theksoi se organizimi i këtij forumi global në Tiranë përfaqëson një dëshmi të transformimit institucional të AMF-së, forcimit të mbikëqyrjes dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm me IAIS përgjatë dekadës së fundit. Ajo nënvizoi gjithashtu rëndësinë e Konferencës si një hapësirë e çmuar dialogu mbi rreziqet, qëndrueshmërinë dhe konsolidimin e mbikëqyrjes në tregjet e sigurimeve.

Vijon ...



Përmbillet me sukses në Tiranë
Konferenca Vjetore Globale e Organizatës Ndërkombëtare të
Mbikëqyrësve të Sigurimeve 2025.
Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, mikëpritësi i këtij aktiviteti.



Konferenca u përshëndet nga Kryeministri i Shqipërisë, z. Edi Rama. Në fjalën e tij përshëndetëse Kryeministri Rama theksoi rëndësinë e bashkëpunimit global, inovacionit dhe nevojën urgjente për zgjidhje të reja dhe të aksesueshme të sigurimit që i përgjigjen një mjedisi ekonomik e klimatik me sfida në rritje. Kryeministri Rama vlerësoi ndikimin e sektorit të sigurimeve në zhvillimin ekonomik, rritjen e qëndrueshmërisë dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Sekretari i Përgjithshëm i IAIS, z. Jonathan Dixon, theksoi se kjo është hera e parë që ky aktivitet i rëndësishëm zhvillohet në rajonin e Ballkanit, duke falënderuar Shqipërinë dhe Autoritetin për organizimin dhe mikpritjen.

Diskutimet e Konferencës sollën së bashku rregullatorë, mbikëqyrës, politikëbërës dhe drejtues të industrisë të cilët theksuan rolin e lidershit rregullator në krijimin e urave mes sektorit të sigurimeve/risigurimeve, qeverive dhe publikut. Gjatë paneleve dhe tryezave të rrumbullakta, pjesëmarrësit trajtuan rëndësinë e zgjidhjeve të përballueshme, të aksesueshme dhe të përshkallëzueshme të sigurimit, që synojnë forcimin e qëndrueshmërisë financiare.

Ky aktivitet shënoi një moment domethënës për zhvillimin institucional të Autoritetit dhe forcimin e partneriteteve me organizatat ndërkombëtare në fushën e sigurimeve.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, janar – tetor 2025


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për janar – tetor 2025 kapën vlerën 22,397 milionë lekë, ose 10.53% më shumë se në janar – tetor 2024. Gjatë periudhës janar – tetor 2025, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,384,414 me një rritje prej 5.12% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.65% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.32% dhe risigurimi me 0.030%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 37.92% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 62.08% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar – tetor 2025, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 6,903 milionë lekë, ose 1.99% më pak se në janar – tetor 2024.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për janar – tetor 2025 kapën vlerën 5,278 milionë lekë, duke pësuar një ulje me rreth 0.35% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Struktura e tregut të sigurimeve, janar - tetor 2025 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar – tetor 2025 arritën rreth 13,903 milionë lekë, ose 12.95% më shumë se në janar – tetor 2024.

ZHVILLIME TË TJERA

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së zhvilloi takim me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar



Tiranë, 7 Nëntor 2025 - Takimi AMF - Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar

Drejtoresha e Përgjithshme e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, zhvilloi një takim me Misionin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), të kryesuar nga znj. Anke Weber, Shefe e Misionit për Shqipërinë.

Bisedimet u fokusuan në zhvillimet më të fundit në tregjet financiare jobankare, politikat mbikëqyrëse dhe avancimin e reformave rregullatore.

Drejtoresha e Përgjithshme e Autoritetit theksoi rëndësinë që i kushtohet monitorimit të vazhdueshëm të treguesve financiarë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, stabilitetit financiar dhe rritjes së besimit të investitorëve e konsumatorëve. Znj. Kaçi prezantoi ecurinë pozitive të tregjeve nën mbikëqyrje përgjatë vitit 2025, ku primet e shkruara bruto në sigurime u rritën me 10.37% për 9-mujorin, aktivet neto të fondeve të investimeve dhe pensioneve private u rritën përkatësisht me 13.68% dhe 9.46% në gjysmën e parë të vitit, ndërsa në tregun e kapitaleve vijoi rritja e obligacioneve të emetuara me ofertë private.

Në takim u nënvizua progresi i bërë për përafrimin e kuadrit ligjor dhe rregullator me acquis të Bashkimit Europian, në kuadër të kapitullit 9 “Shërbimet financiare” nën drejtimin e Autoritetit, si dhe në kapituj të tjerë ku AMF është kontribues.

Në përfundim, znj. Kaçi falënderoi ekipin e Misionit të FMN-së për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe vuri në dukje rëndësinë e programit të vlerësimit të sektorit financiar (FSAP), që do të zhvillohet gjatë vitit të ardhshëm.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi theksoi rëndësinë që i kushtohet monitorimit të vazhdueshëm të treguesve financiarë në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, stabilitetit financiar dhe rritjes së besimit të investitorëve e konsumatorëve.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së pjesë e tryezës së diskutimit në “Eastern Cooperation Meeting” organizuar nga EIOPA



Tiranë, 11 Nëntor 2025 – Tryeza e diskutimit “Eastern Cooperation Meeting” organizuar nga EIOPA

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, mori pjesë në tryezën me temë “Eastern Cooperation Meeting - Insurance Regulation on the Path to European Integration”, organizuar nga Autoriteti Evropian i Sigurimeve dhe Pensioneve Profesionale (EIOPA), në Tiranë. Qëllimi i këtij aktiviteti ishte shkëmbimi i përvojave ndërmjet autoriteteve rregullatore të vendeve anëtare të Bashkimit Europian dhe atyre candidate.

Znj. Kaçi gjatë ndërhyrjes së saj në këtë takim, në cilësinë e negociatores për Kapitullin 9 “Shërbimet Financiare”, u ndal në ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri, si një treg në zhvillim, identifikoi ngjashmëritë dhe sfidat e përbashkëta që hasin në këtë rrugëtim vendet candidate, duke vlerësuar mekanizmat që mundësohen nga EIOPA në lehtësimin e këtyre proceseve integruese.

Pjesëmarrësit diskutuan mbi iniciativat e përbashkëta rajonale, nevojën për forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse me qëllim ndërmarrjen e reformave për përafrimin me acquis të BE-së. Forcimi i stabilitetit financiar, mbrojtja e konsumatorëve dhe nxitja zhvillimit të qëndrueshëm të tregut të sigurimeve mbeten prioritetet e rëndësishme drejt integrimit evropian.

Vijon ...

Znj. Mimoza Kaçi u ndal në ecurinë e tregut të sigurimeve në Shqipëri, si një treg në zhvillim, identifikoi ngjashmëritë dhe sfidat e përbashkëta që hasin në këtë rrugëtim vendet candidate, duke vlerësuar mekanizmat që mundësohen nga EIOPA në lehtësimin e këtyre proceseve integruese.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së pjesë e tryezës së diskutimit në “Eastern Cooperation Meeting” organizuar nga EIOPA



... vijon

Pjesë e këtij takimi ishin përfaqësues të lartë të institucioneve europiane dhe ndërkombëtare: znj. Petra Hielkema, Kryetare e EIOPA-s, z. Vygandas Jankunas nga DG FISMA pranë Komisionit Europian, znj. Danita Pattemore, eksperte e Bankës Botërore dhe z. Peter Braumuller drejtues pranë Autoritetit Austriak të Mbikëqyrjes së Tregut Financiar.

Përfaqësimi në këtë takim konfirmon angazhimin dhe rolin proaktiv të Autoritetit në kuadër të bashkëpunimit rajonal dhe europian.

AMF organizon tryezë diskutimi për përafrimin me Kornizën Ligjore të BE-së për obligacionet e mbuluara 25 nëntor 2025



25 Nëntor 2025, Tiranë – Tryezë diskutimi mbi Vlerësimin e Ndikimit të Politikave për obligacionet e mbuluara

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi një tryezë diskutimi dy ditore, mbi Vlerësimin e Ndikimit të Politikave për obligacionet e mbuluara, me synim përgatitjen e bazës ligjore në përputhje me standardet dhe praktikën e Bashkimit Evropian. Aktiviteti, i mbështetur nga GIZ në kuadër të projektit SANECA II, mbledhi përfaqësues të institucioneve publike, aktorëve të tregut dhe ekspertë ndërkombëtarë.

Në fjalën hapëse, Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive, znj. Mimoza Kaçi, në cilësinë e kryenegociatores së Kapitullit 9 “Shërbimet Financiare”, theksoi se obligacionet e mbuluara përfaqësojnë instrumente financiare të sigurta dhe të qëndrueshme, me potencial për të nxitur zhvillimin ekonomik dhe krijimin e mundësive të reja në investime. Futja e këtij produkti në tregun shqiptar përballet me sfida jo të vogla si menaxhimi i risqeve që lidhen me teknologjinë, sigurinë kibernetike dhe digjitalizimin, si dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të tregut dhe vetë institucioneve rregullatore. Më tej, znj. Kaçi e vuri theksin tek domosdoshmëria e bashkëpunimit të ngushtë ndërinstitucional me qëllim hartimin e një kuadri ligjor të konsoliduar dhe gjithëpërfshirës që të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm të tregut financiar jo-bankar në vend.

Gjatë tryezës, pjesëmarrësit u njohën me përvojat e vendeve të BE-së në krijimin dhe funksionimin e tregut të obligacioneve të mbuluara, modelet mbikëqyrëse dhe kërkesat e raportimit të këtij instrumenti.

Ky aktivitet përfaqëson një hap të mëtejshëm në avancimin e tregut financiar dhe mbështet objektivat e AMF-së për forcimin e kuadrit rregullator dhe përafrimin me standardet e Bashkimit Evropian.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit theksoi se futja e këtij produkti në tregun shqiptar përballet me sfida jo të vogla si menaxhimi i risqeve që lidhen me teknologjinë, sigurinë kibernetike dhe digjitalizimin, si dhe forcimi i kapaciteteve profesionale të tregut dhe vetë institucioneve rregullatore.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, znj. Mimoza Kaçi, pjesë e panelit rajonal në Forum Ekonomik të Brezovicës



26 Nëntor 2025, Kosovë - Forumi Ekonomik i Brezovicës 2025

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mimoza Kaçi, mori pjesë në Forumin Ekonomik të Brezovicës 2025, organizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës në bashkëpunim me Dhomat e Tregtisë të Ballkanit Perëndimor. Ky aktivitet, i cili shërbeu si një platformë rajonale dialogu, mbledhi përfaqësues të komunitetit të biznesit, drejtues të institucioneve financiare, dhe rregullatorë nga vendet e Ballkanit Perëndimor për të diskutuar mbi mundësitë për investime dhe zhvillim ekonomik.

Forumit u përshëndet nga përfaqësuesi i Komisionit Europian, i cili theksoi mbështetjen e KE për nxitjen e investimeve, forcimin e kapaciteteve dhe avancimin e integritimit europian të rajonit.

Në panelin “Qasja në financa dhe mundësitë për investime”, të moderuar nga Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, z. Ahmet Ismaili, krahas Drejtores së Përgjithshme të Autoritetit, znj. Mimoza Kaçi, morën pjesë përfaqësues të lartë të institucioneve financiare dhe bankave qendrore të rajonit, përfshirë Bankën e Shqipërisë dhe Bankën Qendrore të Maqedonisë së Veriut.

Vijon ...

Znj. Kaçi paraqiti zhvillimet e tregjeve financiare jobankare në Shqipëri, përfshirë sfidat dhe nismat e AMF-së për lehtësimin e aksesit në financë, zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare, si dhe orientimin e bizneseve drejt tregut të kapitaleve si mundësi alternative financimi.

Drejtoresha e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, znj. Mimoza Kaçi, pjesë e panelit rajonal në Forumit Ekonomik të Brezovicës

... vijon

Znj. Kaçi paraqiti zhvillimet e tregjeve financiare jobankare në Shqipëri, përfshirë sfidat dhe nismat e AMF-së për lehtësimin e aksesit në financë, zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare, si dhe orientimin e bizneseve drejt tregut të kapitaleve si mundësi alternative financimi. Ajo vuri në dukje gjithashtu rëndësinë e edukimit financiar, veçanërisht për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme si dhe atë të digjitalizimit si prioritet dhe mekanizma kyçe për rritjen e aksesit në financa. Në përfundim, znj. Kaçi theksoi se bashkëpunimi rajonal është thelbësor për zhvillimin dhe intergrimimin e tregjeve të Ballkanit Perëndimor.

Përfaqësimi në Forumit Ekonomik të mbajtur në Brezovicë, dëshmon angazhimin e AMF-së për të thelluar dhe forcuar bashkëpunimin rajonal, si pjesë e përpjekjeve institucionale për zgjerimin dhe modernizimin e tregjeve financiare jo bankare si dhe rritjen e stabilitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre.

BULLARI

www.xprimm.com

Sipas shifrave zyrtare tremujore të publikuara nga Komisioni i Mbikëqyrjes Financiare të Bullgarisë, tregu i sigurimeve në vend, për gjysmën e parë të vitit 2025, raportoi për një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 2.73 miliardë leva ose 1.39 miliardë euro, duke shënuar një rritje prej 17% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i Jetës përbënte 15.26% të vëllimit total të primeve me një vlerë prej 416.8 milionë leva ose rreth 213 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 4.7% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Siguruesit e Jo-Jetës raportuan një vëllim total të primeve me vlerë 2.31 miliardë leva ose rreth 1.18 miliardë euro. Kjo vlerë shënon një rritje prej 19.5% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kontributi më i madh në rritjen e tregut të Jo-Jetës i përkiste segmentit të sigurimeve motorike, i cili kishte një rritje të primeve të shkruara bruto prej 19.16%, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 1.63 miliardë leva ose rreth 835 milionë euro.

KROACI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare, HANFA, në fund të shtatorit 2025, vëllim total i primeve të shkruara bruto, i mbledhur nga siguruesit vendas arriti në 1.54 miliardë euro, nga të cilat 0.24 miliardë euro lidhen me primin e sigurimit të Jetës dhe 1.29 miliardë euro lidhen me primin e sigurimit të Jo-Jetës. Primet e sigurimit të Jetës patën një rënie prej 1.8% ndërsa primet e sigurimit të Jo-Jetës patën një rritje prej 10.17% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Struktura e primit të sigurimit të Jo-Jetës dominohet nga sigurimi i përgjegjësisë ndaj automjeteve motorike (29.8% e PBB-së totale të tregut), e ndjekur nga sigurimi i automjeteve tokësore (16.46%) dhe sigurimi i pronës (15.3%). Në sigurimin e pronës, linja e sigurimit kundër zjarrit dhe fatkeqësive natyrore dhe linja e dëmeve në pronë kontribuan pothuajse në pjesë të barabarta.

Dëmet e paguara në nëntë muajt e parë të vitit 2025 arritën në 883 milionë euro, ku pjesën më të madhe e zinin dëmet e paguara nga sigurimin e Jo-Jetës prej 613.27 milionë euro. Dëmet më të madha lidhen me sigurimin e përgjegjësisë ndaj automjeteve motorike (40.9%), sigurimin e automjeteve tokësore (21.75%) dhe sigurimin e pronës (15.5%).

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave tremujore të tregut të sigurimeve të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve, në Malin e Zi, në fund të shtatorit 2025, tregu i sigurimeve në vend arriti në 112.9 milionë euro, 10% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Vlera e dëmeve të paguara bruto nga siguruesit në vend arriti në 45.84 milionë euro, duke u rritur me 7.5% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Siguruesit e Jetës gjeneruan rreth 18.7% të tregut total të sigurimeve ose 21.1 milionë euro, duke u rritur me 9.27% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës arriti në 91.8 milionë euro ose 10.24% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Dy linjat e biznesit të Jo-Jetës, sigurimi i detyrueshëm MTPL dhe sigurimi Kasko ishin nxitësit kryesorë të rritjes si të vëllimit të primeve të realizuara ashtu edhe të vlerës së dëmeve të paguara.

RUMANI

www.xprimm.com

Tregu rumun i sigurimeve përfundoi gjysmën e parë të vitit 2025 me një vlerë të primeve të shkruara bruto prej 2.43 miliardë euro, ose 6.3% më shumë në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i Jetës arriti në total të primeve prej 508.8 milionë euro dhe rritje prej 18.3% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Segmenti i sigurimit të Jo-Jetës u rrit me 3.5%, duke arritur në 1.92 miliardë euro.

Në gjashtë muajt e parë, tregu pagoi një total prej rreth 1.14 miliardë euro dëme, me një rritje prej 14.16% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Sigurimi i Jo-Jetës gjeneroi pjesën më të madhe të këtyre pagesave, prej 947.7 milionë eurosh, me një rritje prej 17.55% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

SLLOVENI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të prezantuara nga Shoqata Sllovene e Sigurimeve, tregu i sigurimeve në vend u rrit me 22.7% në tremujorin e tretë të vitit 2025, duke arritur në 2.57 miliardë euro. Vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jetës u rrit me 10.4%, duke arritur në 724.7 milionë euro, ndërsa sigurimi i Jo-Jetës gjithashtu u rrit me 28.3%, duke arritur në 1.84 miliardë euro.

Linjat e sigurimit motorik patën, në terma absolutë, kontributin më të lartë në rritjen e primeve. Në përgjithësi, vlera e primeve në sigurimin motorik arriti në 1.03 miliardë euro, 40% më shumë se në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Pjesa më e madhe e kësaj rritje, rreth 84% e rritjes së primeve të sigurimit motorik erdhi nga linja e sigurimit MTPL. Kjo rritje i atribuohet si një numri më të madh policash ashtu edhe një rritjeje të çmimeve të sigurimeve. Përveç kësaj, që nga 1 korriku 2025, skuterët elektrikë duhet të kenë sigurim MTPL, gjë që i shtohet flotës së automjeteve të sigurueshme. Vëllimi i primeve në sigurimin e pronës u rrit me 7.9%, duke arritur në 362.4 milionë euro. Nga ky vëllim total, klasa e sigurimit të Zjarrit dhe Rreziqeve të Ngjashme arritën vlerën e primeve prej 164.46 milionë euro, ndërsa linja e Dëmeve në Pronë realizuan një vlerë prej rreth 198.38 milionë euro.

TURQI

www.xprimm.com

Sipas shifrave tremujore të publikuara nga Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, në fund të shtatorit 2025, tregu vendas i sigurimeve u rrit me 50.2% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 856.83 miliardë lira turke, ose rreth 17.54 miliardë euro. Për shkak të zhvlerësimit prej rreth 28% të Lirës Turke kundrejt euros, e shprehur në monedhën evropiane, ndryshimi i tregut ishte me rritje prej rreth 17.6% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rrit me 81% në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur në 125.38 miliardë lira turke, ose e shprehur në euro u rrit me 41.7%, duke arritur në 2.56 miliardë euro. Në sektorin e sigurimit të Jo-Jetës, vlera e primeve të shkruara bruto u rrit me 45.9%, duke arritur në 731.45 miliardë lira turke ose e shprehur në euro me rritje 14.26% duke arritur në 14.97 miliardë euro.



Për informacion
të mëtejshëm
kontakttoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | ëëë.amf.gov.al